


INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET



Manual Trainimi për
integritetin e Policisë



DCAF
a centre for security
governance and
rule of law

RRUGA DREJT FUQIZIMIT TË INTEGRITETIT

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

Pakoja e
instrumenteve
mbi integritetin
e policisë



RRUGA

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET

Pakoja e
instrumenteve
mbi integritetin
e policisë



Manual Trajnimi për
Integritetin e Policisë

RRUGA DREJT FUQIZIMIT TË INTEGRITETIT



info

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista "Integriteti" është
botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun
dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati Policor i Kosovës

Kryeredaktor:
Arbër BEKA

Bashkëpunëtor:
Arben VRAJOLLI

Tel: +377 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI

4-5

SHBA
përkrah
IPK-në me
trajtime të
avancuara
në fushën e
hetimit



PËRMBAJTJA

IPK INFORMON STUDENTËT

PËR FUSHËVEPRIMIN E SAJ, 6-7

SMIE ÇASJE SISTEMATIKE,

PRO-AKTIVE DHE ME ORIENTIM

STRATEGJIK, 8-9

DCAF FUQIZON KAPACITETET

PËR TRAJNIM TË SPECIALIZUAR MBI

INTEGRITETIN POLICOR, 10-11

SHBA DHURON DONACION

PAJISJE PËR IPK-NË, 15

FUQIZOHET BASHKËPUNIMI MES

IPK-SË DHE KMDLNJ-SË, 20

INSTITUCIONET E VENDIT

ANGAZHOHEN PËR FUQIZIMIN E

ROLIT TË GRUAS NË SEKTORIN E

SIGURISË, 21

IPK JEP INFORMACIONE SHITESË

PËR MISIONIN E SAJ QYTETARËVE NË

GRAÇANICË, 22

1 QERSHOR 2017, 23

18-19

AKSP
mban kon-
ferencën
e parë
shkencore...



12-14

Historik i
shkurtër i
themelimit të
mekanizmave
mbikëqyrës...



16-17

Të rinjtë
për Drejtësi



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të IPK-së.

SHBA PËRKRAH I ME TRAJNIME TË AVAN NË FUSHËN E HE

Në një ceremoni solemne të organizuar në Prishtinë u ndanë certifikatat për 16 hetuesit e IPK-së që ishin pjesëmarrës në “Trajnimin e avancuar për vëzhgim”.

“Trajnimi i avancuar për Vëzhgim”, për hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës, është organizuar nga ICITAP-i Amerikan, dhe është mbajtur

nga instruktorë të FBI-së.

Në këtë ceremoni përveç trajnerëve nga SHBA-të, pjesëmarrës ishin edhe Ambasadori i SHBA-ve në Republikën



IPK-në ICUARA TIMIT

e Kosovës z. Greg Delawie, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Hilmi Mehmeti, Zëvendës ministri i MPB-së z. Behar Selimi, drejtori i AKSP-së z. Smajl Smakiqi, kolonel Riza Shillova etj.

Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së në fjalën e tij të rastit e vlerësoi shumë lart përkrahjen e ICITAP-it amerikan me këtë trajnim dhe trajnimet e tjera për pjesëtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës:

“Besojmë shumë se që nga sot hetuesit e IPK-së, janë më të përgatitur dhe avancuar në aspekte të veçanta dhe shumë të rëndësishme të hetimeve. Mësimet e marra në këtë trajnim nga përvoja e jashtëzakonshme e FBI, hetuesit e certifikuar sot do t’i zbatojnë në punën e tyre të përditshme. Trajnimi dhe përvoja e tyre do të shërbej edhe për punonjësit tjerë të IPK-së, në mënyrë që të punohet me profesionalizëm në fuqizimin e zbatimit të ligjit, përmes zhvillimit të hetimeve profesionale, ne veçanti në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit” – theksoi Kryeshefi Mehmeti duke falënderuar dhe duke qenë shumë mirënjohës gjithë qytetarëve amerikanë dhe Qeverisë Amerikane për ndihmën e



Në një ceremoni solemne të organizuar në Prishtinë u ndanë certifikatat për 16 hetuesit e IPK-së që ishin pjesëmarrës në “Trajnimin e avancuar për vëzhgim”

pakursyer dhe të vazhdueshme për Inspektoratin Policor të Kosovës. Ky trajnim i rëndësishëm është vazhdimësi e mbështetjeve të vazhdueshme drejt ndërtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve

operative të mekanizmave të sigurisë siç është Inspektorati Policor i Kosovës dhe pason edhe donacionet e shumta të pajisjeve për vëzhgim të realizuara nga ICITAP.

IPK INFORMON STUDENTËT PËR FUSHËVEPRIMIN E SAJ



Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) përmes Divizionit për Komunikim me Publikun dhe bashkëpunim ndërkombëtar ka realizuar shumë aktivitete në fushën e bashkëpunimit me qytetarët, duke prezantuar para tyre

rolin, misionin dhe fushë-veprimtarinë e IPK-së.

Një aktivitet i tillë (ligjëratë) me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë”, është mbajtur këtë vit në

bashkëpunim me Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren dhe Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan.

Një aktivitet i tillë me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në



BASHKËPUNIMI ME QYTETARË



Kosovë”, është mbajtur dhe me studentët e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan në ndërtesën e këtij universiteti ku morën rreth 100 studentë.

Pjesëmarrës në këto aktivitete në Prizren dhe Gjilan ishin edhe zyrtarë të EULEX-it, Policisë së Kosovës, MPB-së, ICITAP-it si dhe stafi akademik i dy universiteteve në fjalë, me përkrahjen e të cilëve janë organizuar këto aktivitete. Gjatë diskutimit të hapur me studentë për fushëveprimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), u dhanë shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, inspektimet dhe roli i tyre në ngritjen e profesionalizmit të policisë dhe rëndësinë e integritetit policor.



Studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” morën informacione shtesë edhe për rolin e IPK-së në sundimin e ligjit në Kosovë si dhe për projektin e regjionalizimit të IPK-së respektivisht hapjen e zyrave rajonale në Prizren,

Gjilan dhe Mitrovicën e Veriut.

Ligjëratat lidhur me punën dhe fushëveprimin e IPK-së janë përcjellë me interesim nga studentët ku edhe janë parashtruar pyetje të cilave u kanë dhënë përgjigje zyrtarët e IPK-së.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA/VLADA/GOVERNMENT

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave

SIME

ÇASJE SISTEMATIKE, PRO-AKTIVE DHE ME ORIENTIM STRATEGJIK

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave siguron një orientim strategjik, në ngritjen e përgjegjësisë, përkushtimit dhe koordinimit të shërbimeve mes akterëve si para dhe pas incidenteve. Një qasje sistematike, pro-aktive për udhëzimin e drejtorive dhe agjencive të të gjitha niveleve të qeverisjes, organizatave joqeveritare

dhe sektorit privat për të punuar bashkërisht dhe me vëmendje të përqendruar në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes së efekteve të incidenteve, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre.

Vërshimet e vitit 2005, zjarret e vitit

2007, si dhe incidenti me vajin disulfurik i vitit 2008, kanë potencuar nevojën e përqendrimit në përmirësimin e menaxhimit emergjent, kapaciteteve të reagimit ndaj incidenteve dhe proceseve koordinuese në tërë vendin. Qasja gjithëpërfshirëse kombëtare e aplikueshme në të gjitha nivelet juridiksionale dhe në të gjitha disiplinat



Çka është Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave?

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (SIME), siguron çasje sistematike, pro-aktive për udhëzimin e dikastereve dhe agjencive të të gjitha niveleve të qeverisjes, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat për të punuar bashkërisht dhe me vëmendje të përqendruar në fushën e parandalimit, mbrojtjes, reagimit, rimëkëmbjes dhe zbutjes së efekteve të incidenteve, pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në jetë dhe të mira materiale, si dhe efekteve të dëmshme në mjedis. SIME funksionon dorë më dorë me Planin e Reagimit Kombëtar (PRK). SIME ofron kornizën për menaxhimin e incidenteve, ndërsa PRK ofron strukturën dhe mekanizmin për politikën e nivelit kombëtar të menaxhimit të incidenteve/emergjencave.

funksionale, përmirëson efektivitetin e personelit të menaxhimit/reagimit emergjent, në tërë spektrin e incidenteve të mundshme dhe skenareve të rrezikshme, përfshirë fatkeqësitë natyrore, aktivitetet terroriste dhe fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga faktori njeri. Qasja e tillë përmirëson koordinimin dhe bashkëpunimin midis agjencive/organizatave publike dhe private në aktivitetet e ndryshme të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve. Korniza e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave e avancojnë qasjen gjithëpërfshirëse kombëtare (shih tabelën nr. 1).

Edhe pse incidentet zakonisht fillojnë dhe përfundojnë në rrafshin lokal dhe menaxhohen mbi baza ditore në nivelin më të ulët të mundshëm gjeografik, organizativ dhe juridiksional, prapë se prapë, ekzistojnë rrethana në të cilat operacionet e suksesshme të menaxhimit të incidentit varen nga përfshirja e shumë juridiksioneve, niveleve të qeverisjes, agjencive funksionale dhe disiplinave të shumta të reagimit emergjent. Këto rrethana kërkojnë koordinim efektiv dhe efikas midis këtij spektri të gjerë të strukturave dhe aktiviteteve. SIME përdor çasje sistematike

për integrimin e procesve dhe metodave më të mira ekzistuese, në kornizën e unifikuar kombëtare për menaxhimin e incidenteve. Menaxhimi i incidenteve i referohet mënyrës se si menaxhohen incidentet përgjatë të gjitha aktiviteteve të sigurisë kombëtare, përfshirë parandalimin, mbrojtjen, reagimin dhe rimëkëmbjen.

Kjo kornizë krijon bazat për ndërveprim dhe përputhje të cilat në kthim mundësojnë që organizatat e ndryshme publike dhe private të kryejnë operacione të integruara mirë dhe efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.

Menaxhimi emergjent është integrimi dhe koordinimi i të gjitha aktiviteteve të nevojshme për ngritjen, mbajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve për tu përgatitur, mbrojtur, për të reaguar apo rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore të mundshme apo aktuale, aktet e terrorizmit apo fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga faktori njeri. Këtë e bënë përmes koncepteve, parimeve, procedurave, proceseve organizative, terminologjisë dhe kërkesave standarde të aplikueshme për komunitetin e gjerë të shfrytëzuesve të sistemit.

DCAF FUQIZON KAPACITETIN SPECIALIZUAR MBI INTEGRITETIN



DCAF (Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura) në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Policinë e Kosovës (PK) dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) mbajti punëtorinë katër ditore mbi “Fuqizimin e kapaciteteve për trajnim të specializuar mbi integritetin policor”. 16 zyrtarë nga IPK-ja, PK-ja dhe AKSP-ja vijuan këtë punëtori e cila u udhëhoq nga zyrtarët e DCAF-it.

Gjatë kësaj punëtorie u bë prezantimi i “Manualit të Trajnimit mbi Integritetin Policor” të DCAF-it për përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë dhe u diskutua për implementimin e tij në sistemin e trajnimit policor në Kosovë. Për më tepër, pjesëmarrësit ushtruan se si të mbahet trajnimi mbi integritetin policor



duke përdorur Metodologjitë e Mësimit për të Rritur dhe aktivitetet e përfshira në Manualin e Trajnimit të DCAF-it me qëllim që të ngritën shkathësitë e tyre të fasilitimit/ligjërimit. Në fund të punëtorisë pjesëmarrësit zhvilluan edhe një draft plan të trajnimit i cili mund

të shërbejë si bazë për pilot kursin e trajnimit të zyrtarëve të policisë mbi integritetin policor.

DCAF ka mbështetur Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe institucionet tjera lokale në fuqizimin

TETET PËR TRAJNIM TË TEGRITETIN POLICOR



DCAF (Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura) në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Policinë e Kosovës (PK) dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) mbajti punëtorinë katër ditore mbi “Fuqizimin e kapaciteteve për trajnim të specializuar mbi integritetin policor”. 16 zyrtarë nga IPK-ja, PK-ja dhe AKSP-ja vijuan këtë punëtori e cila u udhëhoq nga zyrtarët e DCAF-it.



e integritetit të shërbimit policor dhe personelit të tij. Aktivitetet e DCAF-it deri më tani përfshijnë një mori tryezash të rrumbullakëta (2013, 2014, 2015) të cilat kanë krijuar platformë për dialog shumëpalësh dhe kanë bërë vetëdijesimin për tema të ndryshme që ndërlidhen me integritetin, siç janë planifikimi i integritetit, bashkëpunimi institucional në fushën e hetimit dhe ndjekjes së sjelljeve të pahijshme të policisë, dhe rëndësinë e mbikëqyrjes së jashtme. Për më



tepër, organizimi i një seminari ndërkombëtar mbi kontrollin dhe

mbikëqyrjen policore në vitin 2015 ka sjell deri te identifikimi i sfidave dhe praktikave të mira në punën e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) dhe në shkëmbimin e përvojave praktike ndërmjet institucioneve të mbikëqyrjes nga vendet e ndryshme.





The history of
HER MAJESTY'S
INSPECTORATE OF
CONSTABULARY

THE FIRST

150
years



HISTORIK I SH MEKANIZMAVE

Llogaridhënia e policisë përballë veprimeve por edhe mos veprimeve të tyre konsiderohet e një rëndësie të madhe, kjo me theks të veçantë në vendet demokratike.

Në vende të ndryshme të botës janë krijuar mekanizma të ndryshëm që bëjnë mbikëqyrjen e policisë dhe roli i tyre në shoqëritë ose vendet demokratike shihet si shumë i rëndësishëm duke siguruar se policia ushtron kompetencat e tyre në përputhje me ligjin dhe standardet më të mira ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të njeriut.


Këta mekanizma mbikëqyrës nuk luajnë thjesht rolin e një agjencie që pranon ankesat e qytetarëve në raport me sjelljet e pahijshme të zyrtarëve policorë duke kryer hetime administrative ose penale. Më shumë duhet parë si një partner strategjik që ndihmon policinë në fuqizimin e integritetit të tyre, që ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve në polici, me inspektimin në fusha të ndryshme duke përfshirë edhe sigurinë publike dhe adresimin e rekomandimeve

për përmirësimin e performancës dhe efektivitetit në polici, ndikojnë në ngritjen e nivelit të profesionalizmit të policisë dhe janë thelbësorë për fuqizimin e integritetit të tyre.


Përderisa nuk ka ndonjë model "ideal" të mekanizmave mbikëqyrës të policisë që do t'i përshtatej secilit shtet, shumica e vendeve në botë kanë krijuar praktika të ndryshme të krijimit por edhe të kompetencave që u janë dhënë këtyre mekanizmave duke pasur parasysh edhe faktorë të shumtë siç janë: niveli i demokracisë në atë vend, kultura e organizatës policore, trendi i sjelljeve të pahijshme nga zyrtarët policorë etj.

Në parim, si faktorë shumë të rëndësishëm janë edhe çështja e pavarësisë operationale të policisë dhe diskrecionit policor në njërën anë dhe garantimi i pavarësisë së mekanizmit mbikëqyrës në anën tjetër.

Sa herë që përmendet mbikëqyrja policore, së paku nga aspekti historik, nuk mund të mos përmendet poeti romak Juvenili (një poet i kohës



SHKURTËR I THEMELIMIT TË E MBIKËQYRËS TË POLICISË



Përderisa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çështja e mbikëqyrjes policore si koncept kishte marrë hapat e parë që nga vitet 1920-ta si pjesë e disa iniciativave për të drejtat e njeriut, në Kosovë ishte viti 2005 kur u filluan përgatitjet e para për themelimin e një agjencie mbikëqyrëse policore nga misioni i OSBE-së në atë kohë

romake, rreth 2000 vjet më parë) që në një prej poezive të tij kishte parashtruar pyetjen “Quis custodiet ipsos custodes?” ose në përkthim në gjuhën shqipe “kush i ruan rojet?”.

Sidoqoftë, fusha e agjencive mbikëqyrëse policore (në kuptimin e agjencive profesionale) në shumicën e shteteve të Evropës dhe në botë në përgjithësi, shihet si një trend i ri që ka filluar të ecë në hapat e zhvillimit dhe fuqizimit të rëndësishëm së tyre.

Si pionier i krijimi të agjencisë mbikëqyrëse policore llogaritet Britania e Madhe kur me Aktin e vitit 1856 u themelua Inspektorati Policor i Madhërisë së saj (Her Majesty’s Inspectorate of Constabulary).

Përderisa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çështja e mbikëqyrjes policore si koncept kishte marrë hapat e parë që nga vitet 1920-ta

si pjesë e disa iniciativave për të drejtat e njeriut, në Kosovë ishte viti 2005 kur u filluan përgatitjet e para për themelimin e një agjencie mbikëqyrëse policore nga misioni i OSBE-së në atë kohë.

Në SHBA, në vitet 1920-1940 mbikëqyrja policore nga ana e qytetarëve shihej si një “ide radikale” e cila ishte e përkrahur vetëm nga grupe të vogla të aktivistëve për të drejtat e njeriut. Ideja e shfaq së pari në vitin 1928 kur Shoqata e Avokatëve të Los Anxhelosit krijuan një Komitet për të Drejtat Kushtetuese që të pranojë ankesa për sjelljen e pahijshme (keqe) të policisë. Sidoqoftë, ky Komitet në atë kohë ishte një trup jozyrtar dhe jo efektiv.

Bordi i parë zyrtar për shqyrtimin e ankesave ndaj zyrtarëve policorë u themelua në Uashington në vitin 1948 edhe pse në kontekstin historik shihet si një inovacion i rëndësishëm, ky



Bord ishte një mekanizëm i dobët duke funksionuar “në mënyrë të heshtur” dhe joefektive pasi për vitet 1948-1964 kishte shqyrtuar vetëm 54 raste-ankesa ndaj zyrtarëve policorë.

Si mekanizëm shumë më i rëndësishëm shihet krijimi i Bordit Këshillues Policor i cili u themelua në vitin 1958 në Filadelfia. Ky Bord përbëhej nga qytetarë të cilët pranonin ankesa në lidhje me sjelljet e pahijshme të policëve dhe i referonte ato për hetime në Departamentin policor të cilët pastaj i kthenin rezultatet e hetimeve te të njëjtit, pas rishikimit të dosjeve ky Bord bënte rekomandime tek Komisari i Policisë për ndërmarrjen e masave të ndryshme.

Lëvizjet për të drejtat e qytetarëve dhe mbikëqyrjes policore u kthyen në një çështje nacionale në SHBA kur këto lëvizje sfiduan sjelljet e pahijshme policore pothuajse në secilin qytet.

Përveç kërkesave për punësimin e afro-amerikanëve si zyrtarë policorë, lëvizjet kërkuan edhe krijimin e bordeve për shqyrtimin e ankesave ndaj zyrtarëve policorë si një prej kërkesave themelore lidhur me të drejtat qytetare.

Për dekada me radhë këto angazhime vazhduan në SHBA duke pasur zhvillime të ndryshme në fushën e mbikëqyrjes policore deri në ditët e sotme kur numërohen mbi 200 agjenci mbikëqyrëse policore që funksionojnë atje.

Është e rëndësishme të cekem edhe faktorët që ndikuan në krijimin e këtyre agjencive-mekanismave. Edhe pse nuk është bërë ndonjë studim akademik i veçantë për të adresuar këtë çështje përmenden disa faktorë si: incidentet serioze të sjelljeve të pahijshme të policisë që në raste të caktuara shkaktuan edhe situata krize që u përcollën edhe

me protesta të dhunshme, mungesa e efektivitetit të njësisve të brendshme hetimore të policisë për të shqyrtuar me objektivitet ankesat e qytetarëve, mungesa e transparencës gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve nga policia, zhvillimi i filozofisë së policimit në komunitet ku parashihej partneriteti me qytetarë në luftimin e kriminalitetit dhe krijimi i mekanizmave të tillë pritej të ndikonte pozitivisht në ndërtimin e besimit reciprok polici-qytetarë, etj.

Lëvizja për mbikëqyrje qytetare të policisë që nga vitet 1970 u ngrit edhe në vendet tjera anglisht folëse dhe jo vetëm në SHBA, ishte një reflektim i shqetësimeve të përbashkëta që u ngrit në të gjitha shoqëritë urbane në tërë botën duke kërkuar mekanizma më efektiv për llogaridhënien policore.

Autori: Arbër Beka



SHBA DHURON DONACION PAJISJE PËR IPK-në

Këto pajisje do ti mundësojnë zyrtarëve të IPK-së që të jenë edhe më të përgatitur drejt zbatimit të ligjit dhe arritjes me sukses të objektivave ligjore. Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si znj. Colleen Hyland - Zëvendës shefe e Misionit Ambasada e SHBA-së në Kosovë, Ministri i Punëve të Brendshme z. Skënder Hyseni, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni, përfaqësues të agjencive të MPB-së etj.

Kryeshefi i Inspektoratit Policor z. Hilmi Mehmeti në fjalimin e tij falënderoi SHBA-të për këtë donacion duke theksuar se fuqizimi i IPK-së do të ishte i pamundur pa mbështetjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ndër vite e veqanërisht ICITAP-it të cilën Inspektorati Policor e konsideron si partner strategjik.

“Nga kjo periudhë dhe deri më sot ICITAP-i ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në trajnime, si në fushën

Inspektorati Policor i Kosovës në një ceremoni rasti në objektin e IPK-së pranoi donacion pajisje nga SHBA-ja.

e hetimeve, poashtu edhe inspektimeve. Ky donacion që po e pranojmë do të ndikojë në rritjen e profesionalizmit, avancimin dhe fuqizimin e Inspektoratit Policor, në menyrë që Inspektorati Policor i Kosovës të jetë model i zbatimit të ligjit, duke kontribuar në rritjen e performancës së Policisë së Kosovës, mbrojtjen dhe respektimin e të lirive



dhe të drejtave të njeriut për qytetaret e Republikës së Kosovës dhe me gjërë” – theksoi ndër të tjera Kryeshefi Mehmeti. Edheznj. Colleen Hyland - Zëvendës shefe e Misionit Ambasada e SHBA-së duke i përshëndetur të pranishmit potencoi edhe disa nga të arriturat e IPK-së duke cekur hapjen e zyrave rajonale duke përfshirë veriun e vendit si dhe përpjekjet e IPK-së drejt ngritjes së vetëdijes publike duke siguruar që sot cdo qytetar të jetë i vetëdijshme për mekanizmat e paraqitjes së ankesave.



TË RINJTË PËR DREJTËSI



Në kuadër të projektit “Të rinjtë për Drejtësi”, YIHR (Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut) në bashkëpunim me koordinatorët lokal nga “EC ma ndryshe” dhe “Syri i Vizionit” janë mbajtur mbi 20 ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme në 10 komuna të Kosovës.

Ligjëratat janë mbajtur në Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan, Podujevë, Prizren, Suharekë, Dragash, Pejë, Deçan dhe Istog. Në këto ligjërata kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës, Institucionit të Avokatit të Popullit, Zyres së Prokurorit Disiplinor dhe Agjencisë kundër Korrupsionit.

Gjatë këtyre ligjëratave, nxënësit kanë mësuar rreth koncepteve të drejtësisë si qasja, të drejtat dhe llogaridhënia e sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, ata

IPK pjesë e projektit për të njoftuar të rinjtë për institucionet e pavarura dhe mbikëqyrëse dhe llogaridhënien e sistemit të drejtësisë

janë njoftuar për institucionet e pavarura dhe mbikëqyrëse si dhe rreth punës që ato kryejnë, nga vetë përfaqësuesit e këtyre institucioneve. Nxënësit kanë shfrytëzuar këtë mundësi për të pyetur këta përfaqësues për çështjet që i shqetësojnë. Pas ligjëratës nxënësit kanë pasur mundësinë të angazhohen në një nga aktivitetet vijuese të projektit duke përfshirë: Turneun vendor të debatit “Karl Popper”, Kampin e Rinisë, përcjelljen e seancave gjyqësore, debatet



lokale.

Së fundi, YIHR planifikon të përmirësojë dhe të promovojë platformën “Njih të drejtat tua”, e cila menaxhohet nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Fillimisht, të rinjtë/ të rejtat do të kenë mundësinë të njoftohen rreth të drejtave që ju takojnë në kuadër të sistemit të drejtësisë dhe të provojnë dijen e tyre rreth

të drejtave në kuadër të kësaj platforme. Për më shumë në bashkëpunim me këtë institucion si dhe Inspektoratin Policor, Zyren e Prokurorit Disiplinor dhe Agjensinë kundër Korrupsionit, të rinjtë/ të rejtat do të informohen rreth këtyre institucioneve dhe do të kenë mundësinë të dorëzojnë ankesa online për çështjet që janë në kompetencë të tyre.





AKSP MBAN KONFERENCËN E PARË SHKENCORE ME TEMËN “SFIDAT E SIGURISË NË KOSOVË”

Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), u mbajt konferenca e parë shkencore me temën “Sfidat e sigurisë në Kosovë”, ku qëllimi i saj ishte që përfaqësuesit e organizatave të sigurisë dhe zbatimit të ligjit në Kosovë të debatoheshin si dhe të prezantojnë gjetjet e tyre më të rëndësishme rreth çështjes së sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Në këtë konferencë ku u debatua për temat që kanë të bëjnë për çështje të sigurisë morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë, Ismail Smakiqi, prof.dr.Ass. Bejtush Gashi, dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike, Drita Perezicq përfaqësuese nga ICTAP-i, Xhon Fisher profesor dr

në Universitetin e Valles në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës Hilmi Mehmeti, ushtrues detyre i Drejtorisë së Përgjithshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës Sokol Zogaj, përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë Publike, përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare, profesorë dhe studentë.

Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në hapjen e kësaj konference tha se sfida e sigurisë është preokupimi kryesor i një vendi.

“Preokupimi i njerëzimit për sigurinë nuk është preokupim i sotëm, është padyshim i vjetër po sa veprimet elementare ekzistencialiste të njerëzimit,

gjegjësisht preokupimi për siguri, pikërisht për shkak të vjetërsisë, pothuaj se është ndjesi e “instinktit”. Andaj sfida e sigurisë sot në botë është pothuajse preokupim ekzistencialistë, sidomos sot kur bota po përballet me preokupime të cilat shpesh duken se e sjellin globin buzë greminës”, u shpreh Smakiqi.

Smakiqi tha se kujdesi ndaj ambientit; zhvillimi ekonomik dhe balancimet sociale ose respektimi i diversiteteve, duhet të jenë fokuset e njerëzimit në aksione për mirëqenie globale.

“Sfidat e sigurisë të cilat sot frekuentojnë në regjione të ndryshme janë të njëjta dhe ato janë; ekstremizmi i dhunshëm, krimi i organizuar, trafikimet e ndryshme, shpëlarja e parave etj”, u shpreh Smakiqi

duke thënë se edhe Kosova si pjesë e globit është vend i sfidave të sigurisë të ngjashme me botën e sidomos me regjionin.

Ndërsa, Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike Bejtush Gashi, duke falënderuar pjesëmarrësit në këtë konferencë, tha se organizimi i saj është i rëndësishëm për Kosovën. Gashi tha se gjatë konferencës do të debatohet për problemet më të cilat po ballafaqohen institucionet konkretisht zbatuesit e ligjit në procesin e ndërtimit të shtetit.

“Kosova ka mundësinë historike të ndërtojë një shtet modern dhe shembull në rajonin tonë, ku shtetasi i saj pavarësisht përkatësisë etnike apo fetare ta ndjejnë vetën të barabartë, ku familjet të jenë të garantuara që të ndërtojnë të ardhmen e tyre sipas kontributeve të barabarta ku shpresa për të ardhmen të bëhet më e madhe se frika nga e kaluara. Vuajtjet e shumta të popullit tonë sigurish se do të jenë një shtysë për të punuar edhe më teje për të siguruar të ardhmen e një Kosovë shumë etnike”, tha Gashi. Gashi tha se siguria është

element kyç në sistemin shtetëror, siguria siç tha ai është një nga shtyllat kryesore prej të cilës varet mirëqenia e përgjithshëm e shtetit të ri. “Kosova ka potencial institucional dhe intelektual të cilët mund të ofrojnë zgjidhje për situatat e krizave, ndërsa përmes zhvillimit të bashkëpunimit dhe integritimit ajo do të rrit kapacitetet e veta”, u shpreh Gashi. Përfaqësuesja e ICITAP-it, Drita Perezic duke folur për mbështetjen që ICITAP ua bënë institucioneve të Sigurisë Publike në Kosovës, e përgëzoi Akademinë për organizimin e kësaj konference duke premtuar mbështetje të mëtutjeshme.

Kurse profesor. Dr Xhon Fisher gjatë fjalimit të tij duke falënderuar Akademinë për mikpritje tha se Amerika ka një miqësi shumë të mirë me Kosovën dhe kjo miqësi do të vazhdojë edhe me tutje. Ai duke folur rreth çështjes së sigurisë tha se organizimi i konferencës është një hap i vogël, por siç tha ia e ka një kuptim të madh për çështjen e sigurisë.

Profesor. Dr. Jonuz Abdullahi në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë u shpreh i lumtur për pjesëmarrjen

në këtë konferencë. “Jam i lumtur që jam këtu sot që së bashku më juve të ndaj përvojat e mija. Erdhi koha që së bashku të kontribuojmë në ndërtimin e institucioneve shtetërore e në veçanti duke i shtuar vëmendje çështjes së sigurisë”, tha Prof.Dr. Abdullahi. Edhe përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë vlerësuan se Kosova si shtet i ri nuk mund të jetë pa sfida rreth çështjes se sigurisë. Ata vlerësuan së organizimi i konferencës me temën “Sfidat e sigurisë në Kosovë”, është një ngjarje e madhe dhe shumë e rëndësishme për vendin. Gjatë konferencës u diskutuan temat si “Kërcënimet Hibride Sfidë Globale e Kohërave Moderne”, nga prof.Dr. Bejtush Gashi dhe Mr.Sc. Ejup Maqedonci, “Kriza politike në Maqedoni dhe ndikimi i saj në sigurinë dhe stabilitetin në rajon”, prof. dr. Jonuz Abdullahi –Uejl dhe Hasan Asani, prof. dr. John R. Ficher dhe Muhaedin Bela “A Policy Analysis Framework to Study the Impacts of the Migrant Problem in the Balkans, the European Union, and the United States” etj.





FUQIZOHET BASHKËPUNIMI MES IPK-SË DHE KMDLNJ-SË

Kryetari i KMDLNJ-së (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut) z. Bexhet Shala së bashku me bashkëpunëtorë vizituan Inspektoratin Policor të Kosovës ku u takuan me Kryeshefin Ekzekutiv të IPK-së z. Hilmi Mehmeti.

Ky takim u realizua në vazhden e fuqizimit të bashkëpunimit në mes KMDLNJ-së dhe IPK-së duke u fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të vendit.

KMDLNJ në vazhdimësi përcjellë informata dhe shqetësimet e qytetarëve në raport me shkeljet eventuale dhe tejkalimet e autorizimeve nga zyrtarët policorë dhe të njëjtit u shprehën të kënaqur edhe me informatat kthyesë që marrin nga IPK-ja në raport me veprimet ligjore që ndërmerren në të

Kryetari i KMDLNJ-së (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut) z. Bexhet Shala së bashku me bashkëpunëtorë vizituan Inspektoratin Policor të Kosovës ku u takuan me Kryeshefin Ekzekutiv të IPK-së z. Hilmi Mehmeti

gjitha rastet/informatat që përcillen nga KMDLNJ-ja.

Përveç tjerash, në këtë takim u diskutua edhe për përmirësimin e kushteve të punës në IPK si parakusht për një punë të suksesshme duke potencuar në mënyrë të veçantë edhe nevojën që IPK të dislokohet me ndonjë objekt në qendër të Prishtinës gjë që do të lehtësonte edhe qasjen e qytetarëve te ky mekanizëm i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit policor.

Si shumë pozitive dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies të Inspektoratit Policor të Kosovës, KMDLNj e vlerësoi edhe faktin se të gjitha palët që trajtohen nga IPK-ja, informohen me kohë për ecurinë e shqyrtimit të ankesave të tyre.

INSTITUCIONET E VENDIT ANGAZHohen PËR FUQIZIMIN E ROLIT TË GRUAS NË SEKTORIN E SIGURISË

Në ndërtesën e
IPK-së u mbajt
takimi i radhës me
përfaqësueset gra të
sektorit të sigurisë

Në kuadër të angazhimeve drejt fuqizimit të rolit të gruas në sektorin e sigurisë, sot në objektin e Inspektoratit Policor të Kosovës u mbajt takimi i katërt me përfaqësueset gra të sektorit të sigurisë në Kosovë.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin znj. Ganimete Musliu - Zëvendëskryetare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, z. Fatmir Shurdhaj – anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Hilmi Mehmeti, kolonel Taibe Canolli – kryetare



Shoqatës së Grave në Policinë e Kosovës, përfaqësues nga Policia e Kosovës, FSK-ja, Avokati i Popullit, OSBE-ja, DCAF-i, etj.

Qëllimi i këtyre takimeve është për të bërë koordinimin e projekteve, aktiviteteve si dhe objektivave të përbashkëta në fushën e mbështetjes së gruas në sektorin e sigurisë nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Nikoqiri i këtij takimi ishte Inspektorati Policor i Kosovës ku në bazë të agjendës u diskutua për çështje që ndërlidhen me rolin e gruas në sektorin e sigurisë duke vënë në pah se padyshim që pjesëmarrja e grave – femrave në sektorin e sigurisë ka luajtur rol të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe fuqizimin e integritetit në sektorin e sigurisë .

Në këtë takim u diskutua edhe për numrin e ankuesve femra që kanë paraqitur ankesa në IPK i cili ka një trend të ngritjes dhe kjo si rezultat i vetëdijesimit të qytetarëve të vendit.

Si pikë e veçantë e diskutimit ishte edhe çështja e kushteve dhe mirëqenies së grave në agjencitë e sigurisë si dhe sfidat që përballen gjatë realizimit të misionit ligjor dhe rekomandimet për masat që mund të ndërmerren drejt përmirësimit të kushteve të punës, mirëqenies së tyre dhe avancimin e pozitës së gruas në vendimmarrje.

Organizimi i këtij takimi u përkrah edhe nga misioni i OSBE-së në Kosovë.





IPK JEP INFORMACIONE SHITESË PËR MISIONIN E SAJ QYTETARËVE NË GRAÇANICË

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) po realizon shumë aktivitete në fushën e bashkëpunimit me qytetarët, me synim dhënien e informacioneve shtesë për rolin, misionin dhe fushëveprimtarinë e IPK-së.

Synimi i këtyre aktiviteteve është fuqizimi i bashkëpunimit me qytetarë por edhe i ngritjes së vizibilitetit të organizatës lidhur me fushëveprimtarinë e IPK-së në përgjithësi dhe “Linjës së kaltër” në veçanti.

Një aktivitet i tillë me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë”, është mbajtur me qytetarët e Graçanicës në ndërtesën e Shtëpisë së Kulturës ku morën pjesë më shumë se 100 qytetarë.


Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me ICITAP –in, Kuvendin Komunal të Graçanicës, Divizionin për siguri në bashkësi të MPB-së dhe Policinë e Kosovës.

Gjatë diskutimit të hapur me qytetarë për fushëveprimimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), u dhanë shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, inspektimet dhe roli i tyre në ngritjen e profesionalizmit të policisë

dhe rëndësinë e integritetit policor.

Qytetarët e Graçanicës morën informacione shtesë edhe për rolin e IPK-së në sundimin e ligjit në Kosovë si dhe për projektin e regjionalizimit të IPK-së respektivisht hapjen e zyrave rajonale në Prizren, Gjilan dhe Mitrovicën e Veriut.





1 QERSHOR 2017

1 Qershor 2017. Policia e Republikës së Kosovës përmes Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë me rastin e ditës ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve në Sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë ka organizuar një aktivitet i cili iu ka dedikuar fëmijëve në radhë të parë por edhe prindërve dhe qytetarëve në përgjithësi. Aktiviteti është përcjellje me një program të pasur artistik nga ana e fëmijëve përmes recitimeve, këndimit dhe vallëzimit. Në këtë aktivitet policorë kanë marrë pjesë rreth 1200 fëmijë të shoqëruar me prindër si dhe 50 zyrtarë policorë nga 5 njësi të ndryshme (Njësia e rendit, Njësia e biçiklistëve, Njësia e motoristëve, Njësia Speciale Operative, dhe Njësia K9). Qëllimi i aktivitetit përveç shënimit të ditës së fëmijëve ka qenë edhe vetëdijësimi i fëmijëve dhe prindërve rreth rëndësisë së raportimit me kohë, rëndësisë së edukimit të fëmijëve në zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në mes të bashkëmoshatarëve si dhe parandalimin e keqpërdorimit të teknologjisë informative dhe rrjeteve sociale të komunikimit nga ana e fëmijëve. Në fund të aktivitetit janë shpërndarë broshura vetëdijësuese për prindër dhe fëmijë, lapsa kimik, fletore etj.





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



080003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION